



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. të datës 03.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 30.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi, renovimi dhe gëlqerosja e institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-9233-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. e datës 03.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 30.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi, renovimi dhe gëlqerosja e institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-9233-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 03.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 30.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi, renovimi dhe gëlqerosja e institucioneve edukative arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-9233-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi ankimor i parë (I): *“Ne dosjen e kanë kërkuar planin dinamik detal por nuk e ka paraqit siq është kërkuar, por ai vetem ka shkruar nje deklarata- mungon plani dinamik detal”.*

Ky pretendim i referohen kërkesës së pestë për kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
5.OE duhet te dorëzoj Planin Dinamik për secilin pozicion të përshkruar në Paramasë. Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri I ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Gjithashtu, së paku në rreshtin e fundit, të shënohen të dhëna për numrin e përgjithshëm të punëtorëve të angazhuar në punishte.	5. Deklarata e nënshkruar.

Nga administrimi i dosjes me të cilën ka ofertuar parashtruesi është gjetur se është dorëzuar plani dinamik i nënshkruar dhe vulosur sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit (për secilin pozicion me numër të ditëve dhe numrin e punëtorëve, etj). Prandaj ky pretendim është i **pabazuar**.

Pretendimi ankimor i dytë (II): *“në listen e makinerisë ka paraqit paisjet e nevojshme me foto, por tuba per hudhjen e mbeturinave nuk i ka paraqit, por ka paraqit vetem kontenier”.*

Ky pretendim i referohen kërkesës së tretë për kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
3.Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij projekti Kamionete, skele, makine për ngjyrosje, tuba për hudhjen e mbeturinave.	3. Liste te paisjeve te nënshkruar nga OE. Libreze qarkullimi valide per kamioneten. Per paisjet tjera te dorezohen foto.

Nga administrimi i dosjes me të cilën ka ofertuar parashtruesi është gjetur se janë dorëzuar fotografitë për skele dhe makinë për ngjyrosje mirëpo nuk janë bashkangjitur edhe fotografitë e tubave për hudhjen e mbeturinave sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit të cituar si më sipër. Në vend të tyre janë bashkangjitur disa kontinier të mbeturinave mirëpo jo tuba për hedhjen e mbeturinave. Prandaj ky pretendim është i **bazuar**.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se pretendimin e tij të dytë mirëpo jo edhe pretendimin e tij të parë ankimor. Për këto arsye është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.11.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.